- Mund të punohet në dysheme të trupit xeheror LI nga $y = 4982$ deri në $y = 5040$.
- Mund të punohet në dysheme të trupit xeheror LII-3 nga $y = 5207$ deri në $y = 5220$.
- Mund të punohet në dysheme të trupit xeheror LII-2 nga $y = 5136$ deri në $y = 5185$.

Profili IX

- Në këtë profil përfshihen lejet minerare nr. L 677/2, L 1270, L 1443, L 1461, L 1155, L 1282/1, L 1544.
- Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror Q (qendror), si dhe në dysheme të trupit xeheror PI, nga $y = 5000$ deri në $y = 5058$, pasi në këtë zonë kemi dalje hinke.
- Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PII nga $y = 4807$ deri në $y = 4851$.
- Mund të punohet në dysheme të trupit xeheror LI nga $y = 5082$ deri $y = 5120$; trupin xeheror LII-1 nga $y = 5137$ deri në $y = 5178$; trupin xeheror LII-2 nga $y = 5134$ deri në $y = 5215$, si dhe në trupin xeheror LII-3 nga $y = 5200$ deri në $y = 5240$.
- Mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PI nga $y = 4807$ deri në $y = 5000$.

**Profili X**

- Në këtë profil përfshihen lejet minerare nr. **L 677/2, L 1443, L 1461, L 1155, L 1544.**
- **Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PII nga $y=4839$ deri në $y=4917$.**
- Mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PI nga $y=5096$ deri në $y=5139$.
- **Nuk mund të punohet në trupin xeheror Q (qendror) se aktivizojmë hinkat e dala në sipërfaqe.**
- Mund të punohet në dysheme të trupit xeheror LI nga $y=5082$ deri $y=5120$.
- **Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror LI nga $y=5149$ deri $y=5189$.**
- Mund të punohet në dysheme të trupit xeheror LII-1 nga $y=5181$ deri $y=5193$; trupin xeheror LII-2 nga $y=5155$ deri $y=5230$; dhe trupit xeheror LII-3 nga $y=5200$ deri $y=5263$.

Profili XI

- Në këtë profil përfshihen lejet minerare nr. **L 677/2, L 1443, L 1155.**
- Mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PII nga $y=4905$ deri në $y=4932$.
- **Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PII nga $y=4865$ deri në $y=4905$.**
- Mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PI nga $y=4868$ deri në $y=5016$.
- **Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PI nga $y=5016$ deri në $y=5094$.**
- **Nuk mund të punohet në trupin xeheror Q (qendror) se aktivizojmë hinkat e dala në sipërfaqe.**
- Mund të punohet në dysheme të trupit xeheror LI nga $y=5122$ deri $y=5162$; trupit xeheror LII-1 nga $y=5243$ deri $y=5275$.
- **Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror LII-1 nga $y=5200$ deri $y=55205$.**
- Mund të punohet në dysheme të trupit xeheror LII-1 nga $y=5198$ deri $y=5272$; trupit xeheror LII-3 nga $y=5261$ deri $y=5336$.

Profili XIII

- Në këtë profil përfshihen lejet minerare nr. **L 677/2; L 1443 (sterile), L 1282/1, L 1544, L 1270 (sterile).**
- Mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PIV nga $y=4807$ deri në $y=4847$.
- **Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PIII dhe PII nga $y=4920$ deri në $y=5033$.**
- Mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PI nga $y=4925$ deri në $y=5072$.
- **Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PI nga $y=5072$ deri në $y=5118$; trupit xeheror Q (qendror) dhe trupit xeheror LI nga $y=5175$ deri në $y=5220$.**
- **Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror LII-1 nga $y=5284$ deri në $y=5310$.**
- Mund të punohet në dysheme të trupit xeheror LII-2 nga $y=5249$ deri në $y=5332$; trupit xeheror LII-3 nga $y=5352$ deri $y=5369$.
- **Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror LII-2 nga $y=5332$ deri në $y=5366$.**

Profili XIV

- Në këtë profil përfshihen lejet minerare nr. **L 677/2; L1282/1; L 1544; L 1443 (ste.).**
- **Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PII nga $y=4940$ deri në $y=5038$.**
- Mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PI nga $y=4941$ deri në $y=5100$.
- **Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PI nga $y=5103$ deri në $y=5143$.**
- **Nuk mund të punohet në trupin xeheror Q (qendror) se aktivizojmë hinkat.**
- **Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror LI nga $y=5187$ deri $y=5240$, trupit xeheror LII-1 nga $y=5288$ deri $y=5311$.**
- Mund të punohet në dysheme të trupit xeheror LII-2 nga $y=5271$ deri $y=5340$.

**Profili XV**

- Në këtë profil përfshihen lejet minerare nr. L 677/2; L 1282/1; L 1443(ste.).
- Mund të punohet në dysHEME të trupit xeheror PIV nga $y = 4873$ deri në $y = 4915$.
- **Nuk mund të punohet në dysHEME të trupit xeheror PIII nga $y = 5013$ deri në $y = 5075$ dhe në trupin xeheror PII nga $y = 4978$ deri në $y = 5075$.**
- Mund të punohet në dysHEME të trupit xeheror PI nga $y = 4979$ deri në $y = 5131$.
- **Nuk mund të punohet në dysHEME të trupit xeheror PI nga $y = 5132$ deri në $y = 5161$.**
- **Nuk mund të punohet në trupin xeheror Q (qendror) se aktivizojmë hinkat.**
- **Nuk mund të punohet në dysHEME të trupit xeheror LI nga $y = 5207$ deri $y = 5235$ dhe në trupin xeheror LII-1, LII-2 nga $y = 5330$ deri $y = 5381$.**

Profili XVII

- Në këtë profil përfshihen lejet minerare nr. L 677/2; L 1282/1; L 1459 (ste.); L 1088.
- **Nuk mund të punohet në dysHEME të trupit xeheror LII-1 nga $y = 5367$ deri $y = 5415$.**
- Mund të punohet në dysHEME të trupit xeheror LII-2 nga $y = 5410$ deri $y = 5445$.

Profili XVIII

- Në këtë profil përfshihen lejet minerare nr. L 677/2; L 1282/1; L 1459 (ste.); L 1088; L 1294.
- **Nuk mund të punohet në dysHEME të trupit xeheror PIII dhe PII nga $y = 5075$ deri në $y = 5104$.**
- Mund të punohet në dysHEME të trupit xeheror PI nga $y = 5105$ deri në $y = 5181$.
- **Nuk mund të punohet në dysHEME të trupit xeheror LII-1 nga $y = 5412$ deri $y = 5426$.**
- Mund të punohet në dysHEME të trupit xeheror LII-2 nga $y = 5412$ deri $y = 5441$.

Profili XIX

- Në këtë profil përfshihen lejet minerare nr. L 677/2; L 1282/1; L 1459 (ste.); L 1088; L 1294.
- **Nuk mund të punohet në dysHEME të trupit xeheror PIII nga $y = 5078$ deri në $y = 5131$.**
- **Nuk mund të punohet në dysHEME të trupit xeheror PII nga $y = 5102$ deri në $y = 5137$.**
- Mund të punohet në dysHEME të trupit xeheror PI nga $y = 5102$ deri në $y = 5150$.
- **Nuk mund të punohet në dysHEME të trupit xeheror LII-1, LII-2 nga $y = 5426$ deri në $y = 5466$.**

Profili XX

- Në këtë profil përfshihen lejet minerare nr. L 677/2; L 1282/1; L 1459 (ste.); L 1088; dhe L 1442 (ste.).
- **Nuk mund të punohet në dysHEME të trupit xeheror PIII nga $y = 5106$ deri në $y = 5155$.**
- **Nuk mund të punohet në dysHEME të trupit xeheror PII nga $y = 5109$ deri në $y = 5156$.**
- Mund të punohet në dysHEME të trupit xeheror PI nga $y = 5109$ deri në $y = 5193$.
- **Nuk mund të punohet në dysHEME të trupit xeheror LII-1 nga $y = 5446$ deri $y = 5461$.**
- Mund të punohet në dysHEME të trupit xeheror LII-2 nga $y = 5464$ deri $y = 5475$.

Profili XXI

- Në këtë profil përfshihen lejet minerare nr. L 677/2; L 1282/1; L 1459 (ste.); L 1088; L 1283 (ste.); L 1163/1 dhe L 1442 (ste.).
- Mund të punohet në dysHEME të trupit xeheror PIII nga $y = 5120$ deri në $y = 5138$.
- **Nuk mund të punohet në dysHEME të trupit xeheror PIII nga $y = 5138$ deri në $y = 5174$.**
- **Nuk mund të punohet në dysHEME të trupit xeheror PII nga $y = 5142$ deri në $y = 5175$.**
- Mund të punohet në dysHEME të trupit xeheror PI nga $y = 5147$ deri në $y = 5193$.
- **Nuk mund të punohet në trupin xeheror Q (qendror) se aktivizojmë hinkat.**
- **Nuk mund të punohet në dysHEME të trupit xeheror LII-1 nga $y = 5463$ deri në $y = 5480$.**



- Mund të punohet në dysheme të trupit xeheror LII-2 nga $y= 5480$ deri $y= 5499$.

Profili XXII

- Në këtë profil përfshihen lejet minerare nr. L 677/2, L 1282/1, L 1459 (ste.), L 1088; L 1283(ste.), L 1163/1 dhe L 1442 (ste.).

- **Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PIII, PII nga $y= 5124$ deri në $y=5159$.**

- Mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PI nga $y= 5159$ deri në $y= 5223$.

- **Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror LII-1, LII-2 nga $y= 5484$ deri në $y=5514$.**

Profili XXIII

- Në këtë profil përfshihen lejet minerare nr. L 677/2; L 1459 (ste.); L 1163/1; L 1442 (sterile.).

- **Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PIII, PII nga $y= 5154$ deri në $y=5178$.**

- Mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PI nga $y= 5178$ deri në $y= 5270$.

- **Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror LII-1 nga $y= 5508$ deri në $y=5533$.**

- Mund të punohet në dysheme të trupit xeheror LII-2 nga $y= 5508$ deri $y= 5521$.

Profili XXIV

- Në këtë profil përfshihen lejet minerare nr. L 677/2; L 1163/1, L 1442 (ste.) dhe L 1283 (ste.).

- **Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PIII nga $y= 5151$ deri në $y=5188$.**

- **Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PII nga $y= 5191$ deri në $y=5217$.**

- Mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PI nga $y= 5190$ deri në $y= 5232$.

- **Nuk mund të punohet në trupin xeheror Q (qendror) se aktivizojmë hinkat.**

- **Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror LI nga $y= 5402$ deri $y= 5419$.**

Profili XXV

- Në këtë profil përfshihen lejet minerare nr. L 677/2; L 1442 (ste.).

- Mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PIV nga $y= 5054$ deri në $y= 5063$.

- Mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PIII nga $y= 5148$ deri në $y= 5181$.

- **Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PIII nga $y= 5181$ deri në $y=5203$.**

- **Nuk mund të punohet në dysheme e trupit xeheror PII nga $y= 5198$ deri në $y=5215$.**

- Mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PI nga $y= 5200$ deri në $y= 5304$.

Profili XXVI

- Në këtë profil përfshihen lejet minerare nr. L 677/2; L 1442 (ste.).

- Mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PIII nga $y= 5174$ deri në $y= 5190$.

- **Nuk mund të punohet në kupolën e trupit xeheror PIII- PII nga $y= 5192$ deri në $y=5235$.**

- **Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PII nga $y= 5233$ deri në $y=5248$.**

- Mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PI nga $y= 5200$ deri në $y= 5307$.

- **Nuk mund të punohet në ullukun e trupit xeheror Q- LI nga $y= 5414$ deri në $y=5464$.**

Profili XXVII

- Në këtë profil përfshihen lejet minerare nr. L 677/2.

- **Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PIII - PII nga $y= 5200$ deri në $y= 5243$.**

- Mund të punohet në dyshemenë e trupit xeheror PIII nga $y = 5175$ deri në $y = 5210$.

- Mund të punohet në dyshemenë e trupit xeheror PI nga $y = 5243$ deri $y = 5294$.

Profili XXVIII

- Në këtë profil përfshihen lejet minerare nr. L 677/2;



- Nuk mund të punohet në sinklinalin Q – LI nga Y= 5458 deri në y= 5590.
- Mund të punohet në dyshemenë e trupit xeheror PIII nga y = 5200 deri y = 5228.
- Mund të punohet në dyshemenë e trupit xeheror PI nga y = 5260 deri y = 5342.
- Mund të punohet në dysheme të trupit xeheror qendrore nga y= 5270 deri në y= 5280.
- Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror LII-1 nga y= 5630 deri në y=5645.

Profili XXIX dhe XXIX/1

- Në këtë profil përfshihen lejet minerare nr. L 677/2.
- Nuk mund të punohet në dysheme të trupave xeherorë Q-LI nga y = 5480 deri në y = 5650, pasi puna këtu bën të mundur dalje të hinkave në sipërfaqe.
- Mund të punohet në dyshemenë e trupit xeheror PIV (gal 48) nga y = 5126 deri në y=5152.
- Mund të punohet në dyshemenë e trupit xeheror sipër PI (Gal 43) nga y = 5267 deri në y = 5344.

Profili XXX

- Në këtë profil përfshihen lejet minerare nr. L 677/2; L 1214/2 dhe L 1485.
- Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PI nga y= 5445 deri në y=5457.
- Nuk mund të punohet në trupin xeheror Q (qendror) se aktivizojmë hinkat.
- Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror LI nga y= 5525 deri y= 5685.

Profili XXXI dhe XXXI/1

- Në këtë profil përfshihen lejet minerare nr. L 677/2; L 1214/2 dhe L 1485.
- Mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PIV nga y= 5130 deri në y= 5200.
- Mund të punohet në dyshemenë e trupit xeheror PIII nga y = 5253 deri y = 5285.
- Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PIII nga y= 5296 deri në y=5320.
- Mund të punohet në dyshemenë e trupit xeheror PII nga y = 5264 deri në y = 5295.
- Mund të punohet në dyshemenë e trupit xeheror PII nga y = 5312 deri në y = 5316.
- Mund të punohet në dyshemenë e trupit xeheror PII nga y = 5331 deri në y = 5333.
- Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PII nga y= 5292 deri në y=5295.
- Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PII nga y= 5310 deri në y=5322.
- Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PII nga y= 5325 deri në y=5320.
- Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PI - Q nga y= 5455 deri në y=5507.
- Mund të punohet në dysheme të trupave xeherorë Q - LI nga y = 5510 deri në y=5600.
- Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror LI nga y= 5610 deri y= 5700.

Profili XXXII

- Në këtë profil përfshihen lejet minerare nr. L 677/2; L 1214/2 dhe L 1485.
- Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PI - Q nga y= 5450 deri në y=5520.
- Mund të punohet në dysheme të trupave xeherorë LI nga y = 5537 deri në y = 5605.

Profili XXXIII dhe XXXIII/1

- Në këtë profil përfshihen lejet minerare nr. L 677/2; L 1214/2.
- Mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PIV nga y= 5145 deri në y= 5164.
- Mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PII nga y= 5290 deri në y= 5343.
- Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PIII nga y= 5295 deri në y=5334.
- Nuk mund të punohet në dysheme të trupit xeheror PI - Q nga y= 5475 deri në y=5545.
- Mund të punohet në dysheme të trupave xeherorë LI nga y = 5568 deri në y = 5695.



Më poshtë, po japim koordinatat e zonave të rrezikshme me dalje hinke dhe të ceduara ku do të bëhet vlerësimi i rrezikshmërisë vetëm për lejet minerare “Stoqe Sterilesh”

Nr.	Koordinatat e zonave	
	X	Y
1	4435171	4594453
2	4435203	4594406
3	4435241	4594384
4	4435274	4594370
5	4435318	4594400
6	4435257	4594414
7	4435233	4594435
8	4435211	4594486
9	4435186	4594504
10	4435192	4594530
11	4435222	4594554
12	4435284	4594548
13	4435298	4594499
14	4435344	4594481
15	4435333	4594451
16	4435372	4594436
17	4435365	4594407
18	4435405	4594364
19	4435457	4594348
20	4435440	4594318
21	4435445	4594295
22	4435498	4594275
23	4435487	4594253
24	4435691	4594212
25	4435666	4594183
26	4435717	4594140
27	4435727	4594113
28	4435756	4594095
29	4435776	4594069
30	4435773	4594048
31	4435815	4594039
32	4435822	4594006
33	4435796	4593993
34	4435756	4593995
35	4435743	4594025
36	4435726	4594040
37	4435703	4594058
38	4435678	4594083
39	4435663	4594100



40	4435644	4594127
41	4435562	4594175
42	4435538	4594172
43	4435507	4594138
44	4435490	4594150
45	4435467	4594174
46	4435451	4594184
47	4435446	4594168
48	4435451	4594144
49	4435423	4594111
50	4435339	4594088
51	4435242	4594158
52	4435273	4594215
53	4435299	4594241
54	4435285	4594267
55	4435202	4594276
56	4435173	4594299
57	4435177	4594325
58	4435138	4594364
59	4435141	4594395
60	4435113	4594416
61	4435087	4594432
62	4435118	4594459

ZONA ME DALJE HINKE 2

Nr.	Koordinatat e Zonave	
	X	Y
1	4435389	4593961
2	4435446	4593984
3	4435476	4593997
4	4435498	4593980
5	4435506	4593951
6	4435513	4593926
7	4435518	4593902
8	4435543	4593856
9	4435607	4593816
10	4435585	4593798
11	4435548	4593806
12	4435466	4593842
13	4435448	4593862
14	4435447	4593889
15	4435432	4593912
16	4435418	4593935

**ZONA ME DALJE HINKE 3**

Nr.	Koordinatat e Zonave	
	X	Y
1	4435552	4593908
2	4435574	4593927
3	4435604	4593917
4	4435578	4593899

ZONA ME DALJE HINKE 4

Nr.	Koordinatat e Zonave	
	X	Y
1	4435755	4593745
2	4435725	4593758
3	4435725	4593786
4	4435787	4593824
5	4435759	4593843
6	4435740	4593866
7	4435695	4593907
8	4435679	4593958
9	4435690	4593972
10	4435704	4593960
11	4435756	4593920
12	4435831	4593915
13	4435892	4593902
14	4435929	4593902
15	4435928	4593873
16	4435979	4593861
17	4435995	4593834
18	4435978	4593816
19	4435955	4593827
20	4435862	4593840
21	4435871	4593865
22	4435874	4593890
23	4435782	4593849
24	4435817	4593827
25	4435813	4593802
26	4435835	4593776

ZONA E CEDUAR B

Nr.	Koordinatat e Zonave	
	X	Y
1	4435289	4594342
2	4435316	4594370



3	4435360	4594354
4	4435369	4594332
5	4435349	4594310
6	4435313	4594323

ZONA E CEDUAR C

Nr.	Koordinatat e Zonave	
	X	Y
1	4435276	4594139
2	4435314	4594160
3	4435404	4594187
4	4435418	4594196
5	4435424	4594188
6	4435375	4594167
7	4435343	4594152
8	4435319	4594130

ZONA E CEDUAR D

Nr.	Koordinatat e Zonave	
	X	Y
1	4435339	4594088
2	4435423	4594111
3	4435405	4594086
4	4435431	4594061
5	4435416	4594036
6	4435457	4594017
7	4435476	4593996
8	4435446	4593984
9	4435404	4593983
10	4435361	4593999
11	4435352	4594025
12	4435332	4594044

ZONA E CEDUAR E

Nr.	Koordinatat e Zonave	
	X	Y
1	4435843	4593875
2	4435871	4593865
3	4435861	4593840
4	4435905	4593831
5	4435955	4593827
6	4435917	4593800
7	4435876	4593813
8	4435819	4593827
9	4435811	4593853



UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 20, datë 20.9.2019

PËR SKEMËN DHE ZBATIMIN E
MODELIT TË FINANÇIMIT TË
INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË
ARSIMIT TË LARTË DHE KËRKIMIN
SHKENCOR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 3, të nenit 110, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimit nr. 75, datë 12.2.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZOJNË:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Financimet në formë granti për institucionet publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor, miratohen nga ministria përgjegjëse për arsimin, sipas kuotave dhe kritereve të përcaktuar me vendimin nr. 75, datë 12.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, në përputhje me kushtet dhe qëllimet e grantit të miratuar, sipas skemës sa vijon;

a) granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë, në programin 09450, kapitulli 01 artikulli 230–231;

b) granti i mësimdhënies, në programin 09450, kapitulli 01, artikulli 604;

c) granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese, në programin 09770, kapitulli 01, artikulli 604-230-231.

2. Detajimi i fondeve, sipas strukturës buxhetore për të gjitha njësitë shpenzuese përfituese të fondeve grant, dërgohet nga nëpunësi autorizues i ministrisë përgjegjëse për arsimin, pranë nëpunësit të parë autorizues për miratim, zyrtarisht dhe në formë elektronike. Pas miratimit,

struktura përgjegjëse në ministrinë përgjegjëse për arsimin, regjistron këtë detajim në sistemin financiar (SIMF).

KREU II

SKEMA E MIRATIMIT DHE E ZBATIMIT
TË FONDEVE “GRANTI I POLITIKAVE TË
ZHVILLIMIT” PËR INSTITUCIONET
PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË

1. Granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë, përfshin:

a) fondin për mbështetjen e institucionit dhe infrastrukturës akademike;

b) fondin e projekteve konkurruese për zhvillimin e institucioneve të arsimit të lartë.

2. Fondi për mbështetjen e institucionit dhe infrastrukturës akademike shpërndahet mbi bazën e renditjes së institucioneve publike të arsimit të lartë, të kryer nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI).

3. Fondi i projekteve konkurruese për zhvillimin e institucioneve publike të arsimit të lartë shpërndahet mbi bazën e projekteve që ato paraqesin, sipas kritereve të përcaktuara në strategjitë sektoriale dhe në ligjin vjetor të buxhetit.

4. Ministri përgjegjës për arsimin, miraton prioritetet, termat e shpërndarjes, formën e aplikimit për grantin, si dhe miraton grantin e politikave të zhvillimit të institucioneve publike të arsimit të lartë, mbi bazën e aplikimit apo të prioriteteve strategjike të zhvillimit të vendit.

5. Fondet e miratuara “grant i politikave të zhvillimit të institucioneve publike të arsimit të lartë”, përparësi në financim do të kenë:

a) projektet në vazhdim nga viti paraardhës ose më parë;

b) projektet e propozuara/ miratuara për financim gjatë vitit ushtrimor, mbi bazën e aplikimit apo të prioriteteve strategjike të zhvillimit të vendit;

c) detyrimet për TVSH ose bashkëfinancimet nga fonde grant për projektet me financim të huaj, do të financohen në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet financiare të projekteve dhe në përputhje me vlerën e financimit të huaj të planifikuar për vitin ushtrimor;

d) financimi i projekteve të reja të propozuara për financim, të shqyrtuara nga Këshilli i Ministrave dhe të paraqitura në Kuvend, për vitin ushtrimor.



6. Fondet e miratuara në formë “granti i politikave të zhvillimit”, në programin buxhetor 09450, kapitullin 01, artikulli 230-231, rishpërndahen sipas projekteve me përfitues institucionet publike të arsimit të lartë, në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin vjetor të buxhetit dhe/ose ligjit të arsimit të lartë, në programin buxhetor 09450, kapitullin 01, artikulli 230-231.

7. Institucionet publike të arsimit të lartë, financojnë ose bashkëfinancojnë, nga të ardhurat e tyre, projekte për rritjen dhe/ose përmirësimin e kapaciteteve të infrastrukturës akademike, si dhe projekte për zhvillimin e institucioneve.

KREU III

SKEMA E MIRATIMIT DHE E ZBATIMIT TË FONDEVE “GRANTI I MËSIMDHËNIES” PËR INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË

1. Granti i mësimdhënies përfshin:

- a) fondin për institucionet publike të arsimit të lartë, në masën jo më pak se 90%;
- b) fondin e mbështetjes studentore, në masën deri në 10% në vit.

2. Fondi institucional u shpërndahet institucioneve publike të arsimit të lartë, sipas një formule të miratuar me vendimin nr. 75, datë 12.2.2018, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”.

3. Fondi i mbështetjes studentore miratuar në formë granti, përfshin tri kategori financimi:

- a) bursat e studimit për studentët e shkëlqyer;
- b) bursat e studimit për studentët në programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar;
- c) bursat e studimit për studentët që u përkasin shtresave sociale në nevojë.

4. Institucionet publike të arsimit të lartë, për një periudhë kalimtare dy deri në tre vjet, në përlogaritjen e formulës për masën e financimit, bazuar në nevojat/kërkesat e tyre specifike do të rivlerësohen, ekualizohen dhe financohen me një fond shtesë.

5. Fondet e miratuara në formë “granti për mësimdhënie për institucionet publike të arsimit të lartë”, në programin buxhetor 09450, kapitullin 01, artikulli 604, miratohen dhe rishpërndahen nga ministria përgjegjëse për arsimin për përfitues institucionet publike të arsimit të lartë.

6. Fondet e miratuara në formë “granti për mësimdhënie për institucionet publike të arsimit të lartë”, shpërndahen me vendim të Bordit të Administrimit, në programin buxhetor 09450, kapitulli 08, artikulli 600–606, mbështetur në objektivat institucionale të IAL publike, si dhe në propozimin e Senatit Akademik, sipas tabelave model nr. 1 dhe nr. 2, të cilat dërgohen zyrtarisht dhe në formë elektronike në ministrinë përgjegjëse për financat për t’u regjistruar në sistemin informatik financiar (SIFQ) dhe për dijeni në ministrinë përgjegjëse për arsimin.

7. Institucionet publike të arsimit të lartë, financojnë apo bashkëfinancojnë nga të ardhurat e tyre, fonde për mësimdhënie, për blerje materiale dhe shërbime, si dhe mbështetje financiare për studentë.

8. Përdorimi i fondeve publike nga Buxheti i Shtetit për institucionet publike të arsimit të lartë, bëhet në përputhje me kushtet dhe qëllimet e grantit të miratuar.

KREU IV

SKEMA E MIRATIMIT DHE E ZBATIMIT TË FONDEVE “GRANTI I PUNËS KËRKIMORE-SHKENCORE DHE I VEPRIMTARIVE KRIJUESE”

1. “Granti i punës kërkimore-shkencore dhe i veprimtarive krijuese” përfshin fondet për kërkimin shkencor, të miratuar me ligjin vjetor të buxhetit në programin 09770, kapitulli 01, artikulli 604, dhe artikulli 230-231.

2. Ky grant është i hapur, për konkurrim/aplikim për të gjitha institucionet e arsimit të lartë të akredituara që zhvillojnë kërkim shkencor.

3. Institucionet e arsimit të lartë të llojit universitet dhe akademi, aplikojnë për të përfituar nga ky grant dhe për financimin e studimeve të doktoratës.

4. Nga ky fond përjashtohet financimi i ngarkesës së pedagogëve për udhëheqjen e doktoratës.

5. Vlerësimi i cilësisë së kërkimit shkencor përbën kriterin bazë të renditjes së institucioneve të kërkimit shkencor nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe përcaktimin e masës së financimit, të përfituar nga



Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë, për IAL-të publike.

6. Institucionet e kërkimit shkencor, marrin masa për vlerësimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë, nëpërmjet njësisë përkatëse, përbërja dhe funksionimi i së cilës përcaktohen në statutin dhe rregulloren e institucionit përkatës.

7. Skema për miratimin dhe shpërndarja e fondeve të kësaj kategorie të miratuara në formën “Granti i punës kërkimore-shkencore dhe i veprimtarive krijuese”, realizohet nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), mbi bazën e projekteve që institucionet paraqesin dhe duke mbajtur në konsideratë treguesit kryesore për projektet kërkimore-shkencore dhe veprimtarinë krijuese të IAL-ve të miratuar me vendimin nr. 75, datë 12.2.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”.

8. Fondet e miratuara me ligjin vjetor të buxhetit “Granti i punës kërkimore-shkencore dhe i veprimtarive krijuese”, në programin buxhetor 09770, kapitullin 01, artikulli 604, rishpërndahet me vendim të Bordit të Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), me përfitues institucionet e arsimit të lartë, të akredituara, që zhvillojnë kërkim shkencor, në programin buxhetor 09770, kapitulli 08, artikulli 602–606. Vendimi i bordit, së bashku me tabelat shoqëruese të detajimit të buxhetit, dërgohen zyrtarisht, si edhe në formë elektronike në ministrinë përgjegjëse për financat për t'u regjistruar në sistemin informatik financiar (SIFQ) dhe për dijeni në ministrinë përgjegjëse për arsimin.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT

1. Fondet e buxhetit të shtetit të miratuara në formë granti apo në formë “transferte e pakushtëzuar” për “Shoqëritë e Trajtimit të Studentëve” sh.a., në Tiranë dhe në rrethe, paguhen në llogarinë bankare të përfituesit nga struktura përgjegjëse për thesarin me urdhër të njësisë së qeverisjes së përgjithshme dhënëse, dhe me paraqitjen nga kjo e fundit të dokumenteve justifikuese të shpenzimit (situacion, fatura, listëpagesa).

2. Kompetencat dhe funksionet e Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, do të ushtrohen nga ministria përgjegjëse për arsimin, deri në momentin e ushtrimit të plotë të funksioneve dhe komepetencave nga Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë.

3. Fondet e përfituara në formë granti nga institucionet publike të arsimit të lartë dhe të papërdorura në fund të vitit financiar në përputhje me rregullat dhe standardet e menaxhimit financiar publik, trashëgohen në vitin pasardhës.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

FONDET GRAND TË DETAJUARA DHE TË MIRATUARA PËR IAL-të PUBLIKE

Tabela nr. 1. Fondet e miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, për vitin financiar.										
Kodi i qeverisjes	Ministria e linjës	Institucioni	Kapitulli	Programi	Llogaria ekonomike	Kodi i qarikut	Kodi i produktit	Emërtimi i produktit	Fondet e detajuara për vitin ushtrimor, në lekë	Aktivitetet të përfshira për të realizuar këtë produkt
001	11	1011136	01	09450	6040000	3737	91105 AA	Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve	X1	Fonde grant për mësimdhënie në IAL publike, shpenzime të personelit, etj., korrente. Fondet Detajohen me Vendim të Bordit Administrimit
001	11	1011136	01	09450	6040000	3737	91105 AA	Studentë që përfitojnë bursa	X2	Fonde grant për mësimdhënie në IAL publike, shpenzime për



								financiare si dhe mbështetje financiare të studentëve		bursa financiare për studentët. Fondet Grant detajohen me Vendim të Bordit të Administrimit
001	11	1011136	01	09450	2310000	3737	M112692	Projekte për zhvillimin institucional	X3	Fonde Grant për Projekte për zhvillimin institucional
001	11	1011136	01	09770	2310000	3737	M112700	Fonde Granti për projekte të punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese.	X4	Fonde Granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese
Totali									Tot=x1+x2+x3+x4	

Tabela nr. 1/8. Fondet e shpërndara me vendim të Bordit të Administrimit për vitin ushtrimor, me burim financimi fondet grant, nga Buxheti i Shtetit për IAL-të publike, të cilat miratohen, sipas strukturës sa vijon:

Kodi i qeverisjes	Ministria e linjës	Institucioni	Kapitulli	Programi	Llogaria ekonomike	Kodi i qarikut	Kodi i produktit	Emërtimi i produktit	Buxheti i detajuar për vitin ushtrimor në lekë	Aktivitetet të përfshira për të realizuar këtë produkt
001	11	1011136	08	09450	6000000	3737	91105AA	Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve	X1	Fonde grant për mësimdhënie në IAL publike, shpenzime të personelit etj., korrente. Fondet detajohen me Vendim të Bordit të Administrimit
001	11	1011136	08	09450	6010000	3737	91105AA	Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve	X1	Fonde grant për mësimdhënie në IAL publike, shpenzime të personelit etj., korrente. Fondet detajohen me Vendim të Bordit të Administrimit
001	11	1011136	08	09450	6020000	3737	91105AA	Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve	X1	Fonde grant për mësimdhënie në IAL publike, shpenzime të personelit etj., korrente. Fondet detajohen me Vendim të Bordit të Administrimit
001	11	1011136	08	09450	6050000	3737	91105AA	Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve	X1	Fonde grant për mësimdhënie në IAL publike, shpenzime të personelit etj., korrente. Fondet detajohen me Vendim të Bordit të Administrimit
001	11	1011136	08	09450	6060000	3737	91105AA	Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve, që përfitojnë bursa financiare si dhe mbështetje financiare	X2	Fonde grant për mësimdhënie në IAL publike, shpenzime për bursa financiare për studentët. Fondet grant detajohen me Vendim të Bordit të Administrimit
001	11	1011136	08	09450	2310000	3737	M112692	Projekte për zhvillimin institucional	X3	Fonde_Për Projekte për zhvillimin institucional
001	11	1011136	08	09770	2310000	3737	M112700	Fonde Granti për projekte të punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese	X4	Fonde Granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese
Totali									Tot=x1+x2+x3+x4	



UDHËZIM

Nr. 10693/2, datë 1.7.2019

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR
KRYERJEN E SHËRBIMEVE TË
VEÇANTA DHE ADMINISTRIMIN E
TYRE NGA AUTORITETET
DOGANORE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 102, datë 31.7.2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të vendimit nr. 651, datë 10.11.2017, të Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, si dhe të vendimit nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për personelin e administratës doganore”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZON:

1. Shërbimet e veçanta dhe tarifave (pagesat) për këto shërbime, jepen në aneksin nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Autoriteti përgjegjës për mbledhjen e tarifave sipas niveleve të përcaktuara në aneksin 1, është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Degët Doganore.

3. Të ardhurat nga tarifave të mbledhura, derdhen 100% (njëqind për qind) në buxhetin e shtetit.

4. Pagesa e tarifës kryhet nga marrësi i shërbimit ose përfaqësuesi i tij.

5. Mënyrat dhe procedurat e arkëtimit të tarifës përcaktohen në aneksin 2, që i bashkëngjitet këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

6. Tarifave publikohen në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

7. Autoriteti doganor ka të drejtën të mos çlirojë mjetin apo mallin për të garantuar tarifën që duhet paguar për shërbimin e marrë.

8. Aktet e nxjerra nga autoritetet doganore për caktimin e tarifave për shërbimet e veçanta të ofruara nga autoritetet doganore shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

ANEKSI 1

TARIFAT PËR KRYERJEN E SHËRBIMEVE TË VEÇANTA

Nr.	Kodi	Klasifikimi i të ardhurës dytësore	Tarifa e shërbimit
1	7111007	Të ardhura nga parkimi në ambientet që administrohen nga autoritetet doganore deri 24 orë:	
		a) Për automjetet	700 lekë (60 minutat e para pa pagese)
		i. kamionë, furgonë deri 10 tonë	700 lekë (60 minutat e para pa pagese)
		ii. kamionët mbi 10 tonë	
b) Për autovetura dhe mikrobusë	i. autovetura dhe mikrobusë 8+1	700 lekë (60 minutat e para pa pagese)	
	ii. autovetura dhe mikrobusë mbi 8+1	700 lekë (60 minutat e para pa pagese)	
Shënim.			
- Nuk ka tarifë shërbimi për parkimin e mjeteve të sipërcituara për kohëzgjatjen deri në 60 minuta.			
- Nuk ka tarifë shërbimi për parkimin e mjeteve të transportit, në rastet kur ato bllokohen në zbatim të një vendimi të nxjerrë nga organ shtetëror/organ gjyqësor.			
2	7113006	Të ardhura nga shtypshkrimet/plumbçe doganore:	
		a) Tarifave të furnizimit ndaj të tretëve me shtypshkrime	Pa pagesë
		i. Certifikatë e origjinës preferenciale të mallrave (EUR1/FORMA A/EUR-MED)	Pa pagesë
ii. Approval Certificate TIR			
b) Tarifave të furnizimit ndaj të tretëve me plumbçe doganore	50 lekë		
3	7111099	Të ardhura për mallrat e të tretëve që magazinohen në magazinat që administrohen nga autoritetet doganore deri 24 orë:	
		a) Për mallrat deri 500 kg ose sipërfaqe deri 2 m ²	500 lekë



		b) Për mallrat mbi 500 kg - 1000 kg ose sipërfaqe mbi 2m ² deri 10 m ²	1000 lekë
		c) Për mallrat mbi 1000 kg - 2000 kg ose sipërfaqe mbi 10 m ² deri 20 m ²	1500 lekë
		ç) Për mallrat mbi 2000 kg - 3000 kg dhe sipërfaqe mbi 20 m ² deri 30 m ²	2000 lekë
		d) Për mallrat mbi 3000 kg ose sipërfaqe mbi 30 m ²	2500 lekë
Shënim. Nuk ka tarifë shërbimi për mallrat që magazinohen, në rastet kur ato bllokohen në zbatim të një vendimi të nxjerrë nga organ shtetëror/organ gjyqësor.			
4	7111099	Tarifa për shërbimet ndaj operatorit ekonomik që kërkon praninë e personelit doganor në ambiente të tjera nga ato doganore (magazina të përkohshme, magazina doganore etj.) ose jashtë orarit zyrtar të punës:	
		a) Një orë pune e një punonjësi të kategorisë C1 është	800 lekë
		b) Një orë pune e një punonjësi të kategorisë C2 është	700 lekë
		c) Një orë pune e një punonjësi të kategorisë C3 është	500 lekë
		Tek kjo tarifë duhet të merren në konsideratë përcaktimet, si vijon: - Mjeti i transportit në të gjitha rastet do të vihet në dispozicion nga operatori ekonomik kërkues; - Koha e transportit do të përllogaritet si kohë pune; - Shtesa e pagesës për orët e punës, pas orarit zyrtar dhe në ditët e pushimit zyrtar llogaritet sipas Kodit të Punës dhe legjislacionit për nëpunësit civil.	
5	7111025	Tarifa e shërbimit për peshimin e mjeteve të transportit:	
		a) Për kamionët, furgonët deri 10 tonë	700 lekë
		b) Për kamionët mbi 10 tonë	1000 lekë
		Te kjo tarifë duhet të merren në konsideratë përcaktimet, si vijon: - Përzgjedhja e mjeteve të transportit për peshim bëhet në bazë të analizës së riskut, përcaktuar me udhëzim të drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.	
6	7113099	Tarifa e shërbimit për ngarkim-shkarkimin e kamionëve për kontroll të plotë fizik:	5000 lekë për mjet
7		Tarifa e parkimit për mjetet e transportit, në rastet kur ato bllokohen në zbatim të një vendimi të nxjerrë nga organ shtetëror/organ gjyqësor	Pa pagese

ANEKSI 2 MËNYRAT DHE PROCEDURAT E ARKËTIMIT TË TARIFAVE

1. Pagesa e tarifës së shërbimit ndaj të tretëve për parkimin e mjeteve apo magazinimin e mallrave, sipas përcaktimeve të pikës 1 dhe 3, të aneksit 1, kryhet nga marrësi i shërbimit ose përfaqësuesi i tij, para daljes të mjetit nga parkimi apo para daljes së mallrave nga magazina.

Zyra e financës në degë doganore, i vë në dispozicion “Faturën për arkëtim”, sipas udhëzimit nr. 19 datë 20.5.2010 “Për përdorimin e faturës për arkëtim” të ministrit të Financave (formati bashkëlidhur aneksi 3) punonjësit doganor përgjegjës për parkimin/magazinën.

Punonjësi doganor përgjegjës për parkimin/magazinën, plotëson “Faturën për arkëtim” në tri kopje dhe ia jep marrësit të shërbimit ose përfaqësuesit të tij. Në “Faturën për arkëtim” duhet të referohen të dhënat në përputhje me Regjistrin e Magazinimit të Përkohshëm të plotësuar bazuar në udhëzimin e DPD “Mbi zbatimin e procedurave të magazinimit të përkohshëm të mallrave”.

Marrësi i shërbimit ose përfaqësuesi i tij me këtë dokument kryen pagesën në bankat e nivelit të dytë për llogarinë e Thesarit.

Një kopje e “Faturës për arkëtim” e vulosur nga banka dhe një kopje e dokumentit që lëshon vetë banka për veprimin e kryer i dorëzohen punonjësit doganor përgjegjës për parkimin/magazinën në



mënyrë që të bëhet i mundur çlirimi i mjetit apo mallit.

Në fund të ditës punonjësi doganor përgjegjës për parkimin/magazinën dorëzon të gjitha “Faturat për arkëtim” në zyrën e financës në degë doganore.

“Faturat për arkëtim” kontabilizohen nga zyra e financës në degë doganore, në një regjistër të

veçantë sipas formularit A si më poshtë. Zyra e financës është përgjegjëse për rakordimin një herë në javë të regjistrit, sipas formularit A, si më poshtë, me të dhënat e regjistruara në Regjistrat e Magazinimit.

FORMULARI A
REGJISTRI DITOR I TARIFËS SË PARKIMIT/MAGAZINIMIT

Nr.	Lloji i mjetit/targa	Lloji dhe sasia e mallit	Emri i marrësit të shërbimit ose përfaqësuesi i tij	Data dhe ora e hyrjes në parkim/magazinim	Data dhe ora e daljes nga parkimi/magazinim	Nr. dhe data e dokumentit të pagesës	Shuma e tarifës së paguar

2. Për plumbçet e përdorura gjatë procedurave, sipas përcaktimeve të shkronjës “b” të pikës 2, të aneksit 1, pritët mandat arkëtimi sipas udhëzimit të DPD-së “Mbi procedurat e administrimit të plumbçeve” në tri kopje.

Punonjësi doganor i autorizuar për përdorimin e plumbçeve në fund të ditës dorëzon te zyra e financës në degë doganore të gjithë shumat e mbledhura dhe dokumentacionin përkatës. Zyra e financës ditën e nesërme të punës kryen derdhjen e shumës së mbledhur në bankat e nivelit të dytë në llogarinë e Thesarit.

Zyra e financës në degë doganore duhet të bëjë kontabilizimin dhe inventarizimin e plumbçeve si artikull i veçantë. Rakordimet midis gjendjes kontabël dhe gjendjes fizike duhet të bëhet jo vetëm në sasi por edhe sipas numrave të serive për të gjitha rastet ku aplikohet plumbosje doganore.

3. Pagesa e tarifës për shërbimet ndaj operatorit ekonomik që kërkon praninë e personelit doganor në ambiente të tjera nga ato doganore ose jashtë orarit zyrtar të punës, sipas përcaktimeve të pikës 4, të aneksit 1, kryhet nga marrësi i shërbimit ose përfaqësuesi i tij.

Operatori ekonomik i interesuar për marrjen e këtij shërbimi, i drejton një kërkesë zyrtare degës së

doganës kompetente. Në rast se kjo kërkesë miratohet, dega e doganës lëshon një urdhër shërbimi ku përcaktohet numri i punonjësve që do të kryejnë shërbimin.

Zyra e financës, mbi bazën e urdhër shërbimit, i vë në dispozicion “Faturën për arkëtim”, punonjësit doganor përgjegjës të shërbimit, i cili në përfundim të shërbimit e plotëson sipas përcaktimeve të pikës 4, të aneksit 1, “Faturën për arkëtim” në tri kopje dhe ia jep marrësit të shërbimit ose përfaqësuesit të tij.

Marrësi i shërbimit ose përfaqësuesi i tij me këtë dokument kryen pagesën në bankat e nivelit të dytë për llogarinë e Thesarit.

Një kopje e “Faturës për arkëtim” e vulosur nga banka dhe një kopje e dokumentit që lëshon vetë banka për veprimin e kryer i dorëzohet punonjësit doganor përgjegjës për shërbimin.

Në fund të ditës punonjësi doganor përgjegjës për shërbimin dorëzon “Faturën për arkëtim” në zyrën e financës në degë doganore.

“Faturat për arkëtim” kontabilizohen nga zyra e financës në një regjistër të veçantë sipas Formularit C si më poshtë.



FORMULARI C
REGJISTRI I TARIFËS SË SHËRBIMIT

Nr.	Lloji i shërbimit të ofruar	Emri i marrësit të shërbimit ose përfaqësuesi i tij	Data dhe ora e nisjes së shërbimit	Data dhe ora e përfundimit të shërbimit	Nr. dhe data e dokumentit të pagesës	Shuma e tarifës së paguar

4. Pagesa e tarifës së shërbimit për peshimin e mjeteve të transportit

Përzgjedhja e mjeteve të transportit për peshim bëhet në bazë të analizës së riskut, përcaktuar me udhëzim të drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.

Marrësi i shërbimit, sipas kërkesës së tij, tërheq te zyra e financës në degë doganore dokumentin “Faturë për arkëtim”.

Marrësi i shërbimit ose përfaqësuesi i tij me këtë dokument kryen pagesën në bankat e nivelit të dytë për llogari të Thesarit.

Një kopje e “Faturës për arkëtim” e vulosur nga banka dhe një kopje e dokumentit që lëshon vetë banka për veprimin e kryer i dorëzohen zyrës së financës në degë doganore.

Shumat e tarifave të arkëtuara kontabilizohen nga zyra e financës në një regjistër të veçantë, sipas formularit D, si më poshtë.

FORMULARI D
REGJISTRI DËTOR I TARIFËS SË PESHIMIT

Nr.	Lloji i mjetit/Targa	Lloji dhe sasia e mallit	Emri i marrësit të shërbimit ose përfaqësuesi i tij	Nr. dhe data e dokumentit të pagesës	Shuma e tarifës së paguar

5. Tarifa e shërbimit për ngarkim-shkarkimin e kamionëve për kontroll të plotë fizik

Përzgjedhja e mjeteve të transportit për kontroll të plotë fizik, bëhet në bazë të analizës së riskut, përcaktuar me udhëzim të drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.

Marrësi i shërbimit, sipas kërkesës së tij, tërheq te zyra e financës në degë doganore dokumentin “Faturë për arkëtim”.

Marrësi i shërbimit ose përfaqësuesi i tij me këtë dokument kryen pagesën në bankat e nivelit të dytë për llogari të Thesarit.

Një kopje e “Faturës për arkëtim” e vulosur nga banka dhe një kopje e dokumentit që lëshon vetë banka për veprimin e kryer i dorëzohen zyrës së financës në degë doganore.

Shumat e tarifës së ngarkim shkarkimit të arkëtuara, kontabilizohen nga zyra e financës në një regjistër të veçantë, sipas formularit E, si më poshtë.

FORMULARI E
REGJISTRI DËTOR I TARIFËS SË SHËRBIMIT TË NGARKIM-SHKARKIMIT

Nr.	Lloji i mjetit/targa	Lloji dhe sasia e mallit	Emri i marrësit të shërbimit ose përfaqësuesi i tij	Nr. dhe data e dokumentit të pagesës	Shuma e tarifës së paguar



ANEKSI 3
FATURË PËR ARKËTIM
Nr. _____, datë _____

Me anë të kësaj fature kërkojmë që banka nivelit të dytë të pranojë nga klientë (persona / persona fizik/persona juridik) arkëtime të të ardhurave, për llogari të institucionit tonë, me emërtimet, kodet dhe shumat si më poshtë :

Emri i institucionit përfitues _____ Dega e Doganës _____
 Kodi i institucionit _____
 Kodi i degës së Thesarit ku vepron _____
 Emri i paguesit (person/ person fizik/ person juridik) _____
 Numri identifikimit të paguesit _____

Nr.	Përshkrimi i të ardhurave		Shuma që Arkëtohet lekë
	Emërtimi	kodi i llogarisë ekonomike	
1			
2			
3			
X	TOTALI	X	0

Përfaqësuesi i institucionit
(emër, mbiemër, nënshkrimi)

(person / person fizik / person juridik)
(emër, mbiemër, nënshkrimi)
Adresa:
Tel.:

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 532 lekë